



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	09	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	50
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	1	Data Datum Date:	05.03.2021
PRISHTINË/A			

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
**Qeveria - Vada - Government**  
**Ministria e Financave**  
**Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance**

Numër: 02/2021

Datë: 05.03.2021

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, nenit 17, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve për Pronat e Paluajtshme në takimin e mbajtur me datë 05.02.2021, nxjerr këtë:

## V E N D I M

*për caktimin e tarifave dhe procedurave për vazhdim Licence për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme*

1. Caktohen tarifat për vazhdimin e Licencës Profesionale Individuale për personat fizik si Vlerësues të Pronave të Paluajtshme, si në vazhdim:
  - i. Aplikimi për vazhdim të Licencës - pesëdhjetë (50) Euro dhe
  - ii. Kërkesa për Licencë në rast të humbjes apo dëmtimit së saj - njëzet (20) Euro
2. Me rastin e aplikimit për vazhdim të Licencës duhet dorëzuar te Sekretariati i Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme dokumentet, si vijon:
  - a) Kërkesë për vazhdim Licence (sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli);
  - b) Vet deklaram që i njëjti/a aktualisht nuk është në procedurë gjyqësore dhe nuk është dënuar në të kaluarën për vepra penale të ndërlidhura me fushë veprimtarinë përkatëse;
  - c) Letërnjoftimi (kopje);
  - d) Licenca e mëparshme (kopje); dhe
  - e) Fletëpagesën sipas tarifës së caktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Kërkesa së bashku me dokumentacionin që e shoqëron atë bëhet në mënyrë elektronike (online) përmes e-mail adresës [KMLVPP.Sekretariati@rks-gov.net](mailto:KMLVPP.Sekretariati@rks-gov.net). Dokumentet duhet të jenë të nënshkruara dhe të skanuara.

4. Sekretariati i KMLVPP-së është përgjegjës për pranimin dhe verifikimin e dokumentacionit sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
5. Sekretariati pas shqyrtimit të dokumentacionit i propozon Këshillit aprovimin apo refuzimin e kërkesës.
6. Personi të cilit i është aprovuar kërkesa pajiset me Licencë me vlefshmëri për periudhën prej një (1) vit nga data e lëshimit të saj.
7. Të gjitha pagesat e tarifave bëhen në llogarinë bankare në Euro.
8. Tarifat e caktuara sipas këtij vendimi janë vendosur për të mbuluar shpenzimet e autoritetit kompetent për të administruar lejimin e licencave.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të jetë i zbatueshëm deri në nxjerrjen e akteve juridike që përcaktojnë kriteret dhe tarifat për aplikim për vazhdim licence.

## ARSYETIM

Bazuar në ndryshimet e ndodhura pas shfuqizimit të vendimeve për themelimin e Bordit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme sipas Vendimit nr. 61/2020 dhe caktimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme me Vendimin e MF nr. 92/2020, sipas nenit 17, paragrafi 4 dhe 5, të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Duke marrë për bazë kërkesat për vazhdim licence nga personat të cilëve tani më ju kanë skaduar, me qëllim të mundësisimit të vazhimit të ushtrimit të funksionit të tyre të vlerësuesit, për të siguruar vazhdimësi të procesit, si dhe duke marrë parasysh kriteret që përcaktojnë Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave dhe Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Këshilli ka marrë këtë vendim për caktimin e tarifave dhe procedurave për vazhdim Licence për Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme.

Rrjedhimisht, është vendosur sipas dispozitivit të këtij vendimi.

  
Agron Thaçi  
Kryesues i Këshillit

Vendimi i'u dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit;
- Sekretarisë së Këshillit; dhe
- Arkivit të MF-së;